



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 39 prot.

Kamëz, më 28.5.2025

V E N D I M
Nr. 34 .Datë 28/5 2025
MBI

“NDRYSHIMIN NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 61, DATË 17.06.2022 MBI: “DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 43, DATË 18.11.2019 PËR: “ORGANIZIMIN E VENDPARKIMEVE TË TRANSPORTIT TAKSI 4+1 NË TË GJITHË TERRITORIN E BASHKISË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 28.05.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.29 Datë 26.05.2025 mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportet Rrugore” i ndryshuar; Udhëzimit nr. 15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.43, datë 18.11.2019 “Për organizimin e vendparkimeve të transportit taksi 4+1 në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz”, i ndryshuar, si dhe referuar relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Licensave dhe Transportit, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 61, datë 17.06.2022 “Mbi disa shtesa në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 43, datë 18.11.2019, “Për organizimin e vendparkimeve të transportit taksi 4+1 në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz”;
2. Në pikën e dytë të paragrafit të dytë të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 61, datë 17.06.2022 “Mbi disa shtesa në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.43, datë 18.11.2019 “Për organizimin e vendparkimeve të transportit taksi 4+1 në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz”, të hiqen 3 vende parkimi, duke bërë ndryshimet si më poshtë vijon:

Ishte: “Të shtohen 30 vende parkimi në Bulevardin “Nënë Tereza”, Kamëz”;

Bëhet: “Të shtohen 27 vende parkimi në Bulevardin “Nënë Tereza”, Kamëz”.

3. Ndryshimi i propozuara me vendndodhjen e saktë të vendparkimeve taksi 4+1 për rrugën e sipërcituar do të jenë sipas relacionit shpjegues të vendimit dhe hartës përkatëse.
4. Për zbatim të ngarkohet Drejtoria e Licensave dhe Transportit.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI

